



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I ARKEOLOGJISË DHE TRASHËGIMISË KULTURORE

PROGRAMI I LËNDËS
Drejtimi: Arkeologji dhe Trashëgimi Kulturore

TITULLI I LËNDËS: GJEOGRAFI E PËRGJITHSHME

Pedagogu: Dr. Albana Kosovrasti
Ngarkesa: 4 ECTS (30 leksione dhe 15 seminare)
Lloji i lëndës: lëndë me zgjedhje
Programi i studimit: Bachelor
Viti/Semestri: II/II

EKSTRAKT

Gjeografia është shkencë e hapësirave dhe e vendeve. Ajo zbulon dhe shpjegon mjedisin gjeografik. “Objekti i gjeografisë dikur ishte zbulimi dhe përshkrimi i botën. Sot ajo synon ta shpjegojë atë dhe të ndihmojë njerëzimin të jetojë në të, pavarësisht konflikteve dhe kontradiktave” (P. George, Les hommes sur la terre, Seghres, 1989.). Nga burim informacionesh dhe zbulimesh, ajo është bërë shkencë që kërkon t’u japë përgjigje pyetjeve fundamentale:

Cilat janë mundësitë dhe kushtet për jetesë?

Si mund të shfrytëzohen ato në mënyrë të qëndrueshme?

Lënda synon t’i pajisë studentët me njohuritë kryesore mbi:

-vendin e Tokës në sistemin diellor, atmosferën, klimën, ndërtimin gjeologjik, relievin, ujërat, dherat, florën, faunën, llojet dhe shpërndarja gjeografike e pasurive natyrore; gjendjen e mjedisit, evolucionin dhe vlerat e peizazheve; rëndësinë e pozitës për lokacionin e vendbanimeve, objekteve ekonomike dhe zhvillimet gjeostrategjike; numrin, lëvizjen natyrore, migruese dhe karakteristikat strukturore të popullsisë; racat, kombet, kulturat, mënyrat dhe nivelin e jetesës së popullsisë, sipas vendeve, grupshteteve, rajoneve etj; llojet, organizimin dhe funksionet e vendbanimeve; shtetet dhe marrëdhëniet ndërshtetërore dhe ndërkombëtare; rajonizimin dhe rajonet kryesore të botës; bazat gjeografike dhe efektet e globalizimit;

Si disiplinë akademike, “Gjeografia e përgjithshme” ka vlera teorike dhe aplikative. Ajo u ofron studentëve koncepte të qarta dhe njohuri të sintetizuara mbi natyrën, popullsinë, ekonominë dhe mjedisin, duke theksuar domosdoshmërinë e zhvillimit të integruar dhe të qëndrueshëm të komponentëve natyrorë dhe humanë.

TEMAT:

LEKSION 1. Struktura e Tokës dhe vendi i saj në sistemin diellor. Atmosfera dhe ndikimi i saj në Tokë. Klima dhe moti (temperatura, erërat, rreshjet, stuhitë etj.). Prirja, shkaqet dhe pasojat e ngrohjes globale.

LEKSION 2. Ndërtimi gjeologjik dhe llojet e shkëmbinjve. Vullkanet dhe tërmetet (mënyra e formimit, arsytet dhe shpërndarja gjeografike). Llojet dhe shpërndarja gjeografike e pasurive nëntokësore.

LEKSION 3. Shpërndarja e burimeve ujore në Tokë dhe ndikimi i tyre në zhvillimin njerëzor. Dherat, bimësia dhe kafshët, llojet dhe shpërndarja e tyre në planet. Burimet natyrore të Tokës, klasifikimi i tyre dhe mënyra e përdorimit.

LEKSION 4. Konceptet kryesore në gjeografinë e mjedisit. Faktorët dhe përmasat e ndotjes, degradimit dhe desertifikimit të mjedisit.

LEKSION 5. Koncepti mbi peizazhin. Peizazhi natyror dhe kulturor. Evolucioni dhe shpërndarja gjeografike e peizazheve. Vlerat estetike të peizazheve.

LEKSION 6. Koncepti i pozicionit gjeografik. Rëndësia e pozitës natyrore, gjeoekonomike dhe gjeopolitike të vendeve dhe rajoneve.

LEKSION 7. Popullsia e botës, numri, dendësia dhe shpërndarja e saj në Tokë. Lëvizja natyrore dhe migruese e popullsisë.

LEKSION 8. Karakteristikat strukturore të popullsisë. Klasifikimet sipas gjuhëve, besimeve dhe kulturave. Racat, kombet, pakicat etnike dhe komunitetet kulturore.

LEKSION 9. Vendbanimet dhe mënyra e jetesës, shpërndarja dhe llojet e tyre.

LEKSION 10. Shteti dhe format e organizimit administrativo-territorial, politik dhe ekonomik të tij. Marrëdhëniet ndërshtetërore. Grupshitetet, organizatat rajonale dhe ndërkombëtare.

LEKSION 11. Organizimi hapësinor dhe rregullimi i territorit. Rajonet dhe rajonizimi i hapësirave. Llojet e rajoneve dhe rëndësia praktike e tyre.

LEKSION 12. Bazat gjeografike të globalizimit. Format kryesore të shfaqjes së globalizimit. Tezat pro dhe kundër globalizimit.

LEKSION 13. Sigurimi i jetesës dhe aktivitetet kryesore ekonomike. Punësimi dhe të ardhurat sipas sektorëve. Shpërndarja shpërpjestimore e pasurive në botë. Papunësia dhe vërfëria.

LEKSION 14. Modelet ekonomike në gjeografi. Ekonomia e centralizuar dhe ekonomia e tregut të lirë. Vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Modeli ekonomik i Kinës.

LEKSION 15. Kompjuterizimi i të dhënave dhe përdorimi i GIS-it në gjeografi.

FORMA E KONTROLLIT DHE E VLERËSIMIT

FREKUENTIMI:

70% e pranisë në seminare e domosdoshme.

15% e notës përfundimtare nga prania dhe angazhimi gjatë kursit apo seminareve.

KONTROLLI I VAZHDUESHËM:

Testi 1 i pjesshëm në javën e 6-të (10% e notës përfundimtare)

Testi 2 i pjesshëm në javën e 10-të (15% e notës përfundimtare): 25% e notës përfundimtare.

DETYRA E KURSIT:

Detyrë kursi ose konspekt i një teksti apo autori ose ese nga 3-5 faqe format A4, Times Neë Roman madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5: *20% e notës përfundimtare.*

KONTROLI PËRFUNDIMTAR:

Një test përfundimtar në javën e 16 të kursit pas kryerjes së 15 javëve të një semestri: *40% e notës përfundimtare.*

DETYRIMET E STUDENTËVE PËR LËNDËN

Frekuentimi i rregullt në leksione.

Frekuentimi i detyruar në të paktën 70% të seminareve të lëndës.

Përgatitja e një ese-je nga 3-5 faqe format A4, Times Neë Roman, madhësia e shkrimit 12, hapësira mes rreshtave 1.5.

Pjesmarrje në testet e pjesshme gjatë semestrit.

Testi(provimi) përfundimtar (i fundit të semestrit).

LITERATURA

1.A. Nonjon, *Concepts et mécanismes de Géographie économique contemporaine*, ellipses, Paris, 1992.

2.G. Eäckermann, *Géographie humaine*, ellipses, Paris, 2000.

3.H. J. De Blij etj., *Human Geography: people, place and culture*, Eighth Edition, John Wiley & Sons, Inc, USA, 2007.

4.J. M. Caron etj., *Comprendre et enseigner la Planete Terre*, OPHRYS, Paris, 1995.

5.A.Kosovrasti *Gjeografia e përgjithshme*, Cikël leksionesh.